

Pranon: Ministria e Drejtësisë

Lënda: Rekomandimet e lëvizjes FOL për një draft ligj të ri të Prokurimit Publik

Data: 31 maj 2011, Prishtinë

Përshëndetje

Prokurimi publik në Kosovë ka një bazë të mirë, por jo të mjaftueshme ashtu siç kërkojnë trendet në botën bashkëkohore të prokurimit publik. Deri më sot Kosova ka avancuar dukshëm në këtë fushë që nga fillimi i IFA-s 2/1999i , më pas ligji 2003/17 dhe së fundi Ligji 03/L-241, mirëpo prapë se prapë ka mbetur boshllëk ligjor dhe praktik në këtë fushë. Komisioni Evropian në raportin e Progresit pati specifikuar disa probleme në fushën e prokurimit publik. Lëvizja Fol ka filluar monitorimin e drejtpërdrejt të procedurave të prokurimit publik me qëllim të avancimit të transparencës dhe llogaridhënës në shpenzimin e parasë publike. Ne, deri më sot kemi arritur marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Drejtësisë duke e nënshkruar memorandum për bashkëpunim dhe me Ministrinë e Administratës Publike. Duke u nisur nga këto parime Lëvizja Fol rekomandon që në ligjin e ri për Prokurim Publik të dominojnë parimet për transparencë dhe standardet e IPA-s për Prokurim publik.

Lëvizja Fol ka kolektuar këto rekomandime fillestare ku ne mendojmë se duhet të përfshihen për amandamentim në ligjin ekzistues ose në ligjin e ri. Lëvizja Fol zotohet se gjatë punës në komision do të kontribuoj me të tjera rekomandime.

1. Qeveria të hartoj një ligj krejtësisht të ri për prokurim publik i cili do të bazohet kryesisht në legjislacionin shqiptar që rregullon këtë fushë dhe në bazë të standardeve evropiane të prokurimit;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës ti kërkoj Komisionit Evropian që me shkrim ti dërgoj Qeverisë të gjitha rekomandimet për ligjin e ri për prokurim publik;
3. Ligji i ri për prokurim publik domosdoshmërisht të rregulloj dhe vendos prokurimin publik elektronik në Kosovë
4. Ligji i ri për prokurim publik të reduktoj burokracinë, duke ofruar prokurim publik që i përgjigjet nenit 120 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet në shpenzimin e parasë publike. Ligji i ri të siguroj procedura të hapura, të thjeshta dhe efektive për prokurim.
5. Ligji i ri të ketë një kapitull të veçantë për “Transparencën dhe Llogaridhënien e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës” I cili do të bazohet mbi këtë parim:
 - a. Të gjitha kontratat publike, (përveç informacionit brenda kontratës që mund të cilësohet sekret dhe hijezohet) dhe dosja e tenderit publikohen në ueb faqen e institucionit përkatës.

- b. Parimet e përgjithshme të transparencës së procesit të prokurimit
 - i. Transparenca qëndron në të gjitha fazat e prokurimit; si në fazën e parë të procesit të prokurimit publik, përmes ofrimit të një informacioni të saktë dhe lehtësisht të qasshëm, ofrimit të një informacioni të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë mundësi të njëjta për të kuptuar dhe për t'u njohur me informacionin e shpallur, ashtu edhe në fazat pasuese gjatë prokurimit, ku palët që kanë pretendime, mund të sqarohen për faza të caktuara të procesit që lidhen me interesin e tyre.
- 6. Ndonëse ligji aktual në Pjesën e Parë, në kreun III respektivisht neni 10 nga paragrafi 1 deri në 9 ka paraparë këto mjete ne rekomandojmë që kjo pjesë e ligjit ekzistuese apo ligjit të ri të përpunohet në tërësi dhe të jetë më e qartë dhe gjithëpërfshirëse. Ne rekomandojmë që të gjitha palët e interesuara që kanë interes për të pasur qasje në dokumentet e prokurimit publik, ligji t'u përcaktoj atyre afatin kohorë për ta gëzuar këtë të drejtë dhe atë në cilën do procedurë me kushte të arsyeshme dhe në përputhje me rregullat. P.sh. nëse ligji aktual në neni 10 thotë: "Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në nenin 8 paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste, që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur". Ne rekomandojmë që kjo të jetë e përcaktuar me afat p.sh. në vend se të thuhet "qasja të menjëhershme dhe të arsyeshme" të thuhet qasje në afatin brenda 2-3 apo 5 ditëve. Dhe po ashtu në vend se të thuhet "me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur" por që qasja të jetë në secilën fazë të aktivitetit me kushte të arsyeshme të cilat nuk do të ndikojnë në pengimin e përfundimit të aktivitetit përkatës të prokurimit.
- 7. Ligji i ri të ketë një kapitull të veçantë për "Parandalimin e Konfliktit të interesit". Një kapitull i cili përkufizon rastet e konfliktit të interesit për zyrtarët e prokurimit.
- 8. Ligji i ri të ketë një Kapitull të veçantë për "Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve"
 - a. Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme: pjesëmarrje në organizatë kriminale; korrupsion; mashtrim dhe pastrim parash.
- 9. Ligji i ri të rivendos vlerën dhe rëndësinë e të ashtuquajturës "Listë e zezë e operatorëve ekonomik" me ç'rast operatorët ekonomik që futen në këtë listë nuk mund të garojnë në tenderë tjerë për dy vite me radhë
- 10. Ligji i ri të fuqizoj mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave publike duke mandatuar/obliguar KRRP të hartoj raporte periodike çdo 3 muaj për zbatimin e kontratave nga Qeveria Qendrore dhe ajo lokale. Raportet të jenë publike dhe ti dërgohen Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit. Këto raporte shqyrtohen në seance të Kuvendit dhe në mbledhje të Qeverisë.
- 11. Ligji i ri ti ndaloj zyrtarët e prokurimit të punësohen në ndërmarrjet të cilat kanë fituar kontrata nga institucioni ky zyrtari ka ushtruar detyrat e tij/saj.
- 12. Mjetet Jurdike-Ankesa- Ligji aktual në nenin 10 edhe pse parashef mundësin e ofrimit të qasjes së menjëhershme dhe të arsyeshme nuk i ka lënë hapësirë palës kërkuese në rastë të refuzimi mjetet të cilat pala mundë ti përdorë ,rekomandimi jonë është përmes

kufizimit kohorë në qasje të parashihen edhe mjetet e ankesës dhe adresa dhe institucioni përkatës ku palët duhet drejtuar në rastë refuzimi. Nga praktika jonë si organizatë kur jemi refuzuar për qasje adresa për t'u mos pajtuar me vendimin gjithmonë ka qenë e pa qartë.

13. Disponshmëria e mjeteve, duke u bazuar në monitorimin e deritanishëm në aktivitetet e prokurimit publik dhe duke parë disa here diskrepancën mes e çmimeve që ofertuesit ofrojnë e cila dallon shumë shpeshherë edhe 1/3 e çmimit të përgjithshëm mes operatorëve ekonomik, ne mendojmë se për kontratat e furnizimit operatorët ekonomik paraprakisht të jenë të informuar për çmimin paraprak. Ne mendojmë se operatorët ekonomik duke ditur disponshmërinë e mjeteve paraprakisht ofertat e operatorëve ekonomik do të jenë të përafërta. Dhe do të hiqet dyshimin që X apo Y operatori ka qenë në dijeni për disponshmërinë e mjeteve dhe në një rast konkret ka ofruar 100E apo 1000E më pak, ndërsa tjetri ka ofruar 10.000E apo 100.000E më shumë. Njoftimi paraprak mbi disponshmërinë e mjeteve i lejon autoritetit kontraktues të fokusohet në kushte tjera të cilësisë, mbikëqyrjes etj.
14. Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, ligji aktual njih 2 kriteret 1.1. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2. tenderuesit që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm. Rekomandimi jonë është se edhe në rastin e parë dhe të dytë ky kriter të përcaktohet në bazë çmimeve për njësi të cilat duhet të jenë në përputhshmëri me çmimet e tregut. Nga përvojat tona gjatë monitorimeve kemi parë se në shumicën e rasteve një njësi e caktuar ka përcaktuar edhe kriterin për çmimin më të ulët dhe ka rezultuar me dhënien e kontratës. Thuajse në shumicën e këtyre rasteve operatori fitues për dallim nga operatorët tjerët ka pasur vetëm një produkt përkatës më të lirë që kjo më pas ka ndikuar në dhënien e kontratës.
15. Neni 61 Tenderët e ulët jashtë Normales- përpos gjitha kushteve që ka paraparë neni 61 në rekomandojmë se tenderët me vlerë të ulët të konsiderohet si vijon: Zyrtari i prokurimit publik pranë autoritetit kontraktues të ketë të drejtë përpos zbatimit të kushteve nga neni 61 LPP-së, edhe të paraqes në prokurori dyshimet për Vepër Penale Mashtrimi siç parasheh edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës në rast se operatori ekonomik tërhiqet nga oferta si rezultat i kërkesës për sqarime nga ana e autoritetit kontraktues.
16. Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për Pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje- Shpeshherë kemi raste kur për shkak të mos përmbushjes së kushteve administrative tenderët anulohen. Rekomandojmë që kontratat publike për furnizim nëse ri-tenderohen dhe se afati të jetë më i shkurtë.
17. Hapja e Tenderëve - Rekomandojmë që të jetë e specifikuar me ligj që formulari i hapjes së tenderit të jetë një pliko e veçantë në të cilët do të jetë vetëm çmimi i përgjithshmen ose për njësi dhe se dokumentet tjera të mos hapen deri tek fillimi i vlerësimit.
18. Vlerësimi i ofertave - është paraparë me legjislacionin detyësorë me rregulloren për prokurim publik, rekomandojmë që procedura e kontrollimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve e paraparë në neni 29 të kësaj rregullore të bëhet pjesë përbërëse e Ligjit për Prokurim Publik dhe se me ligj të përcaktohet se kjo procedurë të jetë transparente dhe e hapur për të gjithë të interesuarit. Kjo do të thotë që për të qenë pjesë në vlerësim, në cilësinë e vëzhguesit duhet që ligji ti mundësoj autoritetit kontraktues që me

vendim të veçantë t'i lejoj të interesuarit, mediat organizatat joqeveritare të jenë pjesë në këtë proces nën kushte të arsyeshme dhe të përgjegjshme .

19. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit - Rekomandojmë të përcaktohet me ligj se të gjithë anëtarët e komisionit për vlerësim të jenë profesionist në fushën përkatëse.
20. Nënshkrimi i Kontratave - Përpos autoritetit ekzistues që bënë nënshkrimin e kontratave rekomandojmë që nënshkrimi i tyre të bëhet edhe nga Ministri i ministrisë përkatëse, kryetari I komunës, çdo drejtor përkatës i autoritetit kontraktues.